



Republika e Kosovës



Komuna e Vushtrrisë

Njesia e Personelit

Vushtrri, më 09.11.2012

Nr. i prot.5665

Në mbështetje nenit 18 paragrafi 1 të Ligjit mbi Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës nr.03/L-149, në bazë të nenit 3 të Rregullores për rekrutimin, nr.02/2010 dhe në bazë të vendimit të Kryetarit të Komunës, nr.1135/12, Udhëheqësi i personelit, shpall:

K O N K U R S

Për vendet e punës:

Drejtoria për Buxhet dhe Financa

I.Vendi i punës:**Zyrtar për taksa komunale**

Numri i ekzekutuesve një(1)

Përshkrimi i shkurtër i detyrave dhe përgjegjësi

Bën shpërndarjen e vendimeve për tarifa dhe ngarkesa për subjektet afariste;

Mbanë evidencën për borxhlinjtë e tarifave dhe ngarkesave dhe të njëjtat i përcjell te inspektori për taksë komunale;

Bën inkasimin e tarifave dhe ngarkesave;

Ndihmon në hartimin dhe plotësimin e Rregullores për Tarifa dhe Ngarkesa Komunale;

Mbanë evidencën e të dhënave për subjektet afariste në mënyrë fizike dhe elektronike;

Lëshon certifikata në bazë të evidencës për palë;

Kryen edhe punë të tjera në kuadër të sektorit, sipas urdhëresës së drejtorit;

Për punën e vet i përgjigjet udhëheqësit të sektorit dhe drejtorit të drejtorisë

Kualifikimi profesional,aftësitë:

Fakulteti ekonomik ose baqelori i ekonomikut

Njohja e mirë e punës në kompjuter në programet Word ,Excel;

Kategoria funksionale:profesionale

Lloji i vendit të punës: Nëpunës i karrierës

Koeficienti 7

Periudha e provuese;një(1) vit .

Drejtoria për ekonomi,bujqësi dhe zhvillim rural

II. Vendi i punës:**Teknik për pyje**

Numri i ekzekutuesve një(1)

Përshkrimi i shkurtër i detyrave dhe përgjegjësi:

Përgatit shënime nga terreni për hartimin e planeve në mbrojtjen e pyjeve;

Kontrollon kryerjen e punëve dhe të dhënave të pranuar nga rojet e pyllit;

Udhëheq librin e dëmeve të pyjeve dhe bën llogaritjen e dëmit të shkaktuar;

Organizon dhe kontrollon punën e shërbimit të rojeve të pyllit, dhe organizon mbrojtjen e pyjeve nga zjarri;

I dorëzon të dhënat nga terreni, shefit të sektorit të pylltarisë;

Kontrollon punët në terren në pyllëzim dhe ripyllëzim dhe për të njëjtat e njofton shefin për pylltari;
Kontrollon vendosjen e rendit pyjor;
Bën reduktimin e trungjeve në pyjet e ulëta në pronë shtetërore dhe private;
Harton gjendjen periodike dhe vjetore të punëve të kryera dhe të njëjtat i dorëzon te shefi i pylltarisë;
Informon për kualitetin dhe kuantitetin e punëve të kryera në terren;
Kryen edhe punë tjera në bazë të urdhrave të shefit të sektorit të pylltarisë.

Kualifikimi profesional, aftësitë:

- Përgatitja e mesme shkollë-drejtimi bujqësi
- Njohja e punës në kompjuter, programet Word, Excel
- Kategoria funksionale, administrative-ekzekutuese
- Koeficienti 5
- Periudha provuese, një(1) vit.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes në mjetet e informacionit publik.

-Paraqitja e kërkesave:

Aplikacionet mund të merren në Zyrën e pranimi ose në faqen e internetit të komunës www.kk.rks-gov.net/vushtrri dhe pastaj dorëzohen në Zyrën e pranimi. Aplikacionit duhet t'i bashkëngjitet: **Kopjen e vërtetuar të Diplomës, kopjen e letërnjoftimit dhe certifikatën e lindjes, certifikatën që nuk është i dënuar dhe nën hetime, certifikatën mbi njohjen e punës në kompjuter, si dhe certifikata tjera mbi trajnimet, të jetë banor i Republikës së Kosovës.**

Aplikacionet e dërguara pas datës së fundit nuk do të pranohen. Aplikacionet e pakompletuara do të refuzohen. Kandidatët të cilët hyjnë në përzgjedhjen e ngushtë për intervistë do të informohen me shkrim ose me telefon në afat ligjor. Për çdo informacion kandidatët mund të drejtohen në Njësine e personelit (zyra numër 8), nr. i tel. 028-572-416.

Shërbimi Civil i Republikës së Kosovës i shërben të gjithë popullit të Kosovës, dhe mirëpret aplikacionet prej meshkujve dhe femrave prej të gjitha komuniteteve të Republikës së Kosovës.

**Udhëheqësi i Personelit
Bislim Dushi**